

FJALA LIRI



**E SHKRUAR NË
ZEMRAT TONA**

DEMOKRACIA, LIRIA E ZGJEDHJES DHE E FJALËS

LORDIAN (13), NDRIQIM (13), ENIS (13), LORIK (14), ORGESA (13), ERIJONA (14), BRENDONA (13)



Liria e fjalës dhe liria e zgjedhjes apo votës së lirë, i japin ende më shumë kuptim demokracisë. Po të mos ishin këto të dyja, atëherë nuk do të quhej demokraci

Shumë të dashur lexues, në artikullin tonë do të keni mundësi të merrni shumë informata rreth demokracisë dhe parimeve të saj

Demokracia është një ndër gjërat elementare të jetës sonë. Jo vetëm për ne, por për të gjithë demokracia ka rol shumë të rëndësishëm. Kjo sepse ky sistem na mundëson që të gjithë ne të trajtohemi në mënyrë të barabartë dhe të mos kemi dallime mes vete apo mes shoqërive. Kur themi dallime, po mendojmë që askush nuk duhet të jetë më i privilegjuar se të tjetrit. Kur nuk ka barazi dhe kur qytetarët nuk ndjehen se po trajtohen në atë mënyrë, atëherë nuk mund të themi që ajo shoqëri zhvillohet në frymë demokratike.

Nëse dëshirojmë të jemi demokratë dhe ta respektojmë demokracinë, duhet t'i përmbushim detyrat dhe përgjegjësitë tona si nxënës, por edhe si qytetarë. Si një ndër përgjegjësitë tona që ne i japim shumë rëndësi është respekti ndaj të tjerëve. Sidomos ndaj personave të cilët nuk janë të komunitetit shumicë.

Ne e dimë se demokracia është sundim i shumicës, pa marrë parasysh asnjë lloj dallimi të mundshëm. Këtë e kemi mësuar në shkollë, në tempullin e dijes njerëzore.

Në këtë tempull, ka pasur raste kur nxënësit nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë. Kjo ka ndodhur edhe në klasën tonë. Por, në klasën tonë nxënësit ishin ata që i bënë këto veprime. Derisa një ditë kujdestari na tërheqi vërejtjen dhe kjo nuk ka ndodhur më.

Tani, secili nga nxënësit i qaset në mënyrë më të butë

tjetrit. Demokracia ka arritur që në zemrat e secilit të mbjell kujdes, dashuri, respekt, mirësi, etj.


Vendi ynë Kosova, u bë pjesë e këtij sistemi të qeverisjes zyrtarisht në vitin 2008, kur u shpall shtet i pavarur dhe demokratik. Ndërsa, demokracia si sistem ka lindur në vitin 507 para erës sonë, në Athinë. Prej nga e ka prejardhjen edhe vetë fjala demokraci, „demo“ që i bie popull dhe „kratia“ qeverisje apo rend, që nënkupton qeverisjen e popullit.

Qytetarët e vendit tonë, qeverisin përmes votës së lirë dhe në këtë mënyrë i zgjedhin përfaqësuesit e vet. Kjo është e njohur si demokraci përfaqësuese. Ndërsa, në demokracinë e drejtpërdrejtë populli nuk zgjedh përfaqësues.

Por, si demokracia përfaqësuese ashtu edhe ajo e drejtpërdrejtë kanë për qëllim arritjen e mirëqenies së qytetarëve. Prandaj, për ne nuk ka rëndësi cila është, me rëndësi që është demokraci.



Demokratë dhe jo vetëm



Pushtetin gjyqësor e përbëjnë gjykatat, të cilat merren me vendosjen e drejtësisë në vendin tonë demokratik



Një votë sjell ndryshimin, prandaj qytetari aktiv tregohet i përgjegjshëm dhe e shfrytëzon të drejtën e votës



Të gjitha ligjet miratohen ose nuk miratohen në institucionin më të lartë legjislativ, në Kuvend. Deputetët janë përfaqësuesit e popullit dhe ata marrin vendime të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e secilit qytetar



Të gjithë fëmijët i kemi të drejtat e barabarta, dhe ato janë: e drejta e shkollimit, e drejta e lojës, e drejta e familjes, etj



Sot kemi pasur rastin të jemi në rolin e gazetarëve, dhe gjatë punës sonë kemi bashkëpunuar me njëri-tjetrin

KUVENDI DHE ROLI I TIJ

FATJON (13), JETON (13), DENIS (13), RINORA (12), CANA (13), ERNIS (13), DASHMIR (13),

ARRDIT (13)



Ne, nxënësit e klasës së VIII-të nga Deçani, diskutuam dhe mësuam shumë për institucionin më demokratik të vendit, i cili është Kuvendi. Lexoni artikullin në vazhdim që të mësoni edhe ju

Kuvendi është organi më i lartë legjislativ në Republikën e Kosovës. Ky institucion është shumë i rëndësishëm për qytetarët, sepse miraton ligjet, kontrollon punën e kabinetit qeveritar, si dhe deputetët të cilët punojnë në Kuvend, përfaqësojnë popullin.

Kuvendi i Kosovës përbëhet nga 120 deputetë, ku 100 prej tyre janë të kombësisë shqiptare dhe 20 prej tyre nga komunitetet jo shumicë (serbë, romë, ashkali, egjiptianë, boshnjakë, turq dhe goranë). Çdo parti politike duhet të kalojë pragun prej 5% të votave për të marrë mandate në Kuvend. Ligjet, rregulla të cilat duhet t'i zbatojmë dhe t'i respektojmë, bazohen në Kushtetutën e Kosovës, aktin më të lartë juridik të shtetit. Ligjet mund të propozohen nga Qeveria, deputetët, Presidenti dhe qytetarët nëse i kanë 10.000 e më shumë nënshkrime. Para se të bëhen ligje, ato fillimisht propozohen si projektligje dhe dërgohen në komisionin përkatës për t'u diskutuar dhe shqyrtuar. Pasi bëhet shqyrtimi i projektligjeve, duhet të votohet nga deputetët, të cilët pastaj i miratojnë ose nuk e miratojnë ato. Ligjet e miratuara pastaj dërgohet në Presidencë dhe nënshkruhet nga Presidenti. Në fund, publikohen në gazetën zyrtare të Kuvendit të Kosovës. Pasi të publikohen, ligjet duhet të zbatohen nga gjithë

qytetarët. Këto janë disa informata rreth Kuvendit të Kosovës. Le të imagjinojmë një situatë në jetën e përditshme, kur ne si fëmijë kemi propozuar dhe kemi votuar. Arsimtari sapo erdhi në klasë dhe na njoftoi për një ekskursion që mund të ndodhte me klasën tonë. Ne si klasë edhe pse patëm preferenca të ndryshme, votuam për vendet që i pëlqenim më shumë, diskutuam dhe në fund propozuam që të shkonim në qendrën e skijimit, në Bogë. Pastaj, vendosëm që ta dërgonim kërkesën në drejtorinë e shkollës. Pas aprovimit nga drejtori, arsimtari fotokopjoi disa fleta në të cilat kishte informata rreth ekskursionit duhej nënshkrimi i prindërve. Kështu, prindërit u pajtuan dhe ne patëm rastin që të kalojmë një ditë shumë të bukur në vendin që ne veçse dëshironim ta vizitonim. Shpresojmë që e keni kuptuar rolin tonë si qytetarë kur marrim iniciativa të ndryshme si dhe rolin e Kuvendit në jetën tonë.



Grupi „Ligjvënësit“

E DREJTA E INFORMIMIT

DION (13), HATMONE (13), ALBIOS (14), SYARTA (13), AHMET (13), ELVISA (13), ARIAN (14)



Qëllimi kryesor i medias është që të na mbajë të informuar dhe të na vetëdijësojë për të drejtat të cilat neve na garantohen me qeverisjen demokratike

Në demokraci, ne kemi të drejtë të informohemi dhe t'i informojmë të tjerët

Jemi në vitin 2018 dhe jetojmë në një epokë ku forma e qeverisjes e quajtur demokraci, ka vërshuar një pjesë të madhe të botës. E në mesin e shumë shteteve demokratike është Kosova, e cila që nga viti 2008 e gëzon zyrtarisht këtë sistem.

Qytetarët e Kosovës sikurse të gjithë qytetarët e botës të cilët jetojnë në demokraci, kanë shumë të drejta të cilat mbrohen nga Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut. Një të drejtë të cilën ne e kemi, e që ne duam të shtjellojmë në këtë artikull është e drejta e informimit. Kjo e drejtë mundësohet dhe realizohet përmes medias. Por, ne informohemi edhe nga njerëzit e tjerë. Kur flasim për median, ne e ndajmë atë në dy lloje: në media të shkruara, ku përfshihen: librat, revistat, gazetetat, etj., dhe media elektronike,

ku përfshihen: radio, televizioni, interneti, etj.

Për shebull, shumë ambasadorë nga fusha të ndryshme, kanë arritur të bëjnë të njohur shtetin tonë. E kjo është realizuar përmes medias. Disa nga ambasadorët e njohur të Kosovës janë: Lorik Cana, Majlinda Kelmendi, Nora Gjakova, Luan Krasniqi, Robin Haxhi Krasniqi, Gzim Selmani, Milot Rashica, Rita Ora, Bebe Rexha, Dua Lipa, etj.

Në disa raste, e drejta e informimit keqpërdoret përmes burimeve të rrejshme. Por, kjo gjë duhet të ndalohej, sepse media çdoherë duhet të prezantoj vetëm të dhëna faktike.


Media është burim informacioni, i cili informon qytetarët për zhvillimet e fundit dhe i vetëdijëson ata për të drejtat e tyre. Media i ka lidhur njerëzit e kontinenteve të ndryshme dhe për këtë, ajo ka një rol tejet të rëndësishëm në shoqërinë tonë.

Përmes medias, ne kemi pasur mundësi të përjetojmë shumë ngjarje emocionuese dhe mjaft mbresëlënëse për ne. Njëra nga këto ngjarje është ngritja e flamurit të Kosovës në Lojërat Olimpike të vitit 2016, nga xhuditja Majlinda Kelmendi, e cila u shpall kampione bote në Rio 2016.

Pra, e drejta e informimit është një nga të drejtat bazike, e cila na ndihmon që të kemi një shoqëri demokratike e me të drejta të barabarta. Po ashtu, informimi i drejtë dhe i mirë, krijon shoqëri mendjehapur dhe civilizim të mirëfilltë.



Ne iu mbajmë të informuar për çdo gjë, sepse jemi gazetarë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Drita“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VIII
Website: www.demos-ti.org Vendi: Gramaqel, Deçan